



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 666/2 prot.

Tiranë, më 10. 06. 2022

V E N D I M

Nr. 112, datë 10. 06. 2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 81 regj., datë 24.05.2022, S. B., kundër Autoritetit Kombëtar të Ushqimit¹, Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Kukës² dhe Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Kukës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim *për çdo shkak tjetër*³.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, S. B., në parashtrimet e paraqituara në ankesën e sjellë pranë KMD-së, informon se, ka mbajtur pozicionin e shërbimit civil si Inspektore në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në Drejtorinë Rajonale AKU Kukës që nga viti 2011 deri në vitin 2014.

Që nga data 24.11.2014 me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm AKU-së ankuesja thekson se është larguar nga detyra dhe përjashtuar nga shërbimi civil për shkak se nuk ka pranuar të bashkëpunojë me inspektorët e tjerë të AKU Kukës dhe të bëhet pjesë e akteve korruptive gjatë ushtrimit të detyrës.

Ankuesja parashtron se largimi i saj nga puna është organizuar nga kolëgët e saj në bashkëpunim me subjektet që tregtonin mish për konsum të popullatës. Shkaku i organizimit të këtij

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën AKU.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën AKU Kukës.

³ Për shkak të të qenit femër intelektuale dhe e ndërgjegjshme në punën e saj madje e pakorruptuar.

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

bashkëpunimi, sipas ankueses, ka qenë se ajo nuk ka pranuar të lejojë therjen, tregimin e mishit jashtë kushteve higjienike apo kontrollit veterinar dhe për këtë ka ndërmarrë veprime për bllokimin e aktiviteteve private të cilat kanë vepruar në shkelje të legjislacionit.

Gjithashtu, ankuesja pretendon se asaj i mohohet e drejta kushtetuese për një gjykim të drejtë e të paanshëm nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Kukës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë. Përfaqësuesit e organeve të sipërcituara, sipas saj, gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre, nuk kanë gjykuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, çështjet e paraqitura prej saj.

Përsa më sipër, ankuesja pretendon se zgjidhja e marrëdhënieve të punës, nga ana e AKU-së, është një veprim i cili lidhet me faktin që ajo nuk ka pranuar të bashkëpunojë me inspektorët e tjerë të AKU Kukës dhe të bëhet pjesë e akteve korruptive gjatë ushtrimit të detyrës. Në këtë kuptim, kërkon nga Komisioneri, të konstatojë situatën diskriminuese nga ana e AKU-s dhe Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Kukës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, për shkakun e pretenduar.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *“bindjes politike”* duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 3, i ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pika 1, gërma a), b) dhe c), të LMD, i ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe*

përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Nga aktet e administruara, rezulton se ankuesja pretendon se ndaj saj është kryer sjellje diskriminuese më datë 24.11.2014. Këtë moment ajo e lidh me momentin e largimit nga detyra. Gjithashtu, rezulton se lidhur me sjelljen diskriminuese me të cilën ajo pretendon se është përballur, ka marrë dijeni më datë 24.11.2014.

Në kontekst të sa më sipër, ankuesja ka marrë dijeni për sjelljen diskriminuese të pretenduar, që në datë 24.11.2014. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 24.05.2022, pra më vonë se dy vite nga marrja dijeni.

Referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e S. B., nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

- *Lidhur me kundërshtimin e vendimeve të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Kukës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.*

Ankuesja në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me problematikën që ka patur, sa i përket veprimeve të kryera në dëm të saj, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Kukës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

Në përfundim, organet gjyqësore të cituara më sipër, pasi kanë shqyrtuar ankimet e subjektit ankues, i kanë rrëzuar ato. Në këto kushte ankuesja ka pretenduar pranë Komisionerit se vendimet e ndërmarra prej tyre janë diskriminuese për shkakun se nuk është bërë pjesë e akteve korruptive gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet

ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.

Përsa më sipër dhe referuar informacionit të vënë në dispozicion nga ana e ankueses, ajo ka ezauruar rrugën e ankimit të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe denoncimit të shkreljeve të kryera nga përfaqësuesit e AKU-së, duke u shqyrtuar ato nga ana të gjithë organeve të sistemit gjyqësor në Shqipëri. Pra, në këto kushte, verifikimi i procedurave të ndjekura nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Kukës, janë bërë objekt i shqyrtimit nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

Neni 36, i Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, në paragrafin 3, parashikon se: “...*Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...*”

Mbështetur në legjislacionin e sipërcituar dhe në kushtet që procedura e ndjekur nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Kukës, është shqyrtuar nga organet gjyqësore, në këtë situatë Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pra, Komisioneri nuk mund të vlerësojë vendimarrjen e gjykatave të sipërcituara.

Në nenin 33, pika 4, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) është anonime; b) ... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” dhe “dh” të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesja S. B., nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit, paraqitet më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/dh dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, S. B., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)